

**VENDIM**  
**Nr. 143, datë 21.3.1997**

**PËR NJË TRANSFERIM TË FONDEVE BUXHETORE SHËRBIMIT INFORMATIV  
KOMBËTAR NGA FONDET E AKORDUARA PËR GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME  
MINISTRISË SË BRENDSSHME**

Për mbajtjen në gatishmëri të efektivave dhe përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme, me propozimin e Shërbimit Informativ Kombëtar, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në planin e shpenzimeve buxhetore të tremujorit të parë të vitit 1997, Shërbimit Informativ Kombëtar i shtohen 25 milionë lekë për pagesën e punonjësve.

2. Shtesa prej 25 milionë lekësh të pakësohet nga plani i shpenzimeve të Ministrisë së Brendshme, akorduar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.121, datë 7.3.1997 “Për një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Brendshme për përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme”.

3. I rekomandohet Shërbimit të Kontrollit të Shtetit të ushtrojë kontroll mbi shpenzimet e kryera nga Shërbimi Informativ Kombëtar për gjendjen e jashtëzakonshme dhe të paraqesë për këtë raportin e plotë në Këshillin e Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Bashkim Fino**